



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:211156
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06155784

P.nr.190/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.H. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1151/24 e datës 17.07.2024, e përmirësuar nga prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar me datë 11.09.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 11.09.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, e dëmtuara H.G., mbrojtësi i viktimave Isa Aruqi dhe i pandehuri F.H., më datë 11.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.H. nga i ati K..., e ëma H..., e gjinisë H..., data e lindjes... në Vushtrri, me vendbanim në Vushtrri, me numër personal ..., ka të kryer fakultetin e inxhinierisë softuerike, punon në Prishtinë si inxhinier i softuerë-it në kompaninë Exlusive Group, i shkurorëzuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, edhe më parë i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 03.07.2024, rreth orës 17:30, në Vushtrri në rrugën “A.SH.”, saktësisht në banesën e të dëmtuarës H.G., nuk i bindet Aktvendimit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil C.nr.1918/24 i datës 16.05.2024 i cili është valid në kohëzgjatje prej 12 muajve, ku është aprovuar kërkesa e palës së dëmtuar, ashtu që i pandehuri urdhërohet që të ndërpres dhe të mos përsërisë asnjë veprim të dhunshëm ndaj palës së mbrojtur, personave në marrëdhënie familjare me të, kafshëve shtëpiake apo të mos dëmtoj pasurinë, ashtu që i ndalohet, që në mënyrë të drejtpërdrejte, përmes kamerave të tretë çfarëdo lloj mënyre të komunikoj, të ngacmoj, të shqetësoj, manipulojë, ofendojë, kërcënojë, përndjekë apo të vëzhgoj palën e mbrojtur dhe personat në marrëdhënie familjare me të, po ashtu i ndalohet që ti ofrohet në një distancë prej 50 metra brenda vendbanimit në Vushtrri rruga “A.SH.” hyrja A6 kati 8, numër 35, si dhe jashtë këtij vendbanimi në distancë prej 10 metrave, palës së mbrojtur, mirëpo pavarësisht kësaj i

pandehuri nuk i bindet urdhrorit të gjykatës dhe me datë 03.07.2024, shkon në banesën e të dëmtuarës ku e njëjta ndihet e shqetësuar pasi që i njëjti ka pasur të ndaluar të ofrohet në distancë prej 10 metrave, dhe ju drejtohet me fjalë “vij kur të dua unë”, duke sjellë në gjendje të tillë të frikësohet për jetën e mirëqenien e saj,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: F.H. i shqipton DËNIM MË GJOBË në shumën prej një mijë e dyqind euro (1200) euro i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 euro (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1151/24 e datës 17.07.2024, kundër të pandehurit F.H. nga Vushtrria, për shkak të veprave penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1, të cilën në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 11.09.2024 e ka përmirësuar sa i përket gjendjes faktike ku nga rreth orës 22:40 e ka ndryshuar në rreth orës 17:30.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 11.09.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri F.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtun gjykatës që në të ardhmen kjo vepër dhe veprat e tjera nuk do të përsëriten më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e tij, pasi që ky deklarim i tij është bërë me vullnetin e tij dhe pas udhëzimeve të gjykatës dhe po ashtu se ky pranim gjene mbështetje në të gjitha provat e që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykatës i propozon që në rast të aprovimit të pranimit të fajësisë me rastin e përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer ndërsa si rrethanë rëndese të merret parasysh që kryerja e kësaj vepre ka rezultuar në shqetësimin e personit tjetër pra të ish bashkëshortes së tij, çka vet ligjvënësi parasheh që në këto raste këto vepra konsiderohen të jenë kryer brenda marrëdhënies familjare, andaj kjo rrethanë të i mirët si rrethanë rënduese duke shtuar që, gjykata sipas detyrës zyrtare e sipas mundësive të pajiset me një certifikatë nga e kaluara kriminale, dhe varësisht se çka rezulton nga e njëjta të i mirët si rrethanë lehtësuese respektivisht rënduese.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështetë në tersi fjalën e prokurores së shtetit sa i përket pranimit të fajësisë dhe ne po ashtu i propozon gjykatës që të bej aprovimin e të njëjtit ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jo material pas konsultimit me palën e dëmtuar e njëjta kërkon që të ketë kompensim material dhe jo material lidhur me këtë çështje.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit dhe njëherit kërkon kompensim të dëmit material dhe jo material lidhur me këtë çështje.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BD-600, i datës 04.07.2022, raporti i oficerit, i datës 04.07.2024, shënimi zyrtar i hetuesit, i datës 04.07.2024, raporti ditor, i datës 03.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për ankuesin H.G., i datës 03.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin F.H., i datës 04.07.2024.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprat penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 393 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale

Mospërfillja e gjykatës e kryen “*Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimin të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin se i njëjti ka qenë edhe ma parë i dënuar për vepra të llojit të njëjtë e cila është konstatuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykim P.nr.620/21 i plotfuqishëm me datë 10.01.2022, në Gjykatën Themelore në Prishtinë për veprën penale dhunë në familje si dhe se kjo vepër penale është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe vetë dispozitat ligjore e parashohin si rrethanë rënduese.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “*Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi*”. Kjo pasi që në seancën e shqyrtimit fillestar pala e dëmtuar H.G. ka kërkuar kompensim të dëmit por nuk ka pasur prova të mjaftueshme që të përcaktohet shuma.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.190/2024, datë 12.09.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.